REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 668/22
Datë/Datum. 06.12.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
Samire Sahiti	21.11.2022	*06.12.2022*	PSH nr. 668/22

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18-11-2022, OE "Albi Company shpk"- Rahovec, ka parashtruar ankesë, kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë OE "U-UNIQUE SH.P.K"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi- renovimi i objekteve me vlera historike kulturore ne Qytetin e Prizrenit" me nr. të prokurimit: 622-22-9594-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prizrenit
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë. Vlera e parashikuar e kontratës: 150,000.00€.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Ekspertja Shqyrtuese i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimet ankimore të OE ankues:
Neni 6 i LPP-së;
Neni 7 i LPP-së;
Neni 59 i LPP-së;
Neni 60 i LPP-së;
Neni 69 i LPP-së.

Deklaratë detale sipas OE ankues:
Vendimi mbi refuzimin e Kerkesen per rishqyrtim nga ana e AK-se KK Prizen

1. nuk qëndron asnje pretendim ankimorë i parashtruar nga ana juaj lidhur me OE te cilin autoriteti kontraktues Komuna e Prizrenit e ka propozuar për kontratë.

Ak KK Prizen ne pergjigjen rreth refuzimit te ankesen nuk ka kthyer pergjigje as nuk ka ofruar kunder argumente per te githa pikat ankimore te parashtruar nga ne si OE ne ankese.

Argumentet e ofruar nga ne si OE ne ankese jane te qarta se OE fitues eshte i pa pergjegjeshem po ashtu edhe OE tjere konkurrues jane te pa pergjegjeshem

Argumentat jane se OE fiteus eshte i pa pergjegjshem pasiqe :

Nuk ka ofruar deshmi se ka realizuara projekt te natyres se projektit dhe natyra e projektit eshte Ndertim-renovim i objekteve me vlera historike kulturore - Prove Lista e kontratave, Kontratat- Referencat, Pranimet e puneve.

Menaxheri i projektit nuk ka ofruar reference se ka menaxheruar nje projekt sipas natyres se projektiit, natyra e projektit eshte Ndertim-renovim i objekteve me vlera historike kulturore, po ashtu Ne CV, Referencen ka informata qe nuk perputhen duhet konsideruar si te pa vlefshme

Nuk ka dorezuar kontrata-parakontrata per gjithe stafin e kerkuar se paku 10, por vetem per 9 persona ka dorezuar kontrata-parakontrata.

AK-se nuk ka afruar kunder-argumente as nuk eshte pergjigjur rreth pikanve ankimore te parashtruara ndaj OE BG- ING - AGE GROUP dhe OE HYSEN SOPA BI (NNSH EMSA)

2. Me rastin e propozimit te OE për kontratë, autoriteti Kontraktues Komuna e Prizenit ka pasë parasyshe faktin se Institucionet buxhetore duhet te rrespektojne parimin e kursimit dhe te shpenzimit te parasë publike, pasi që OE i propozuar për kontrate ka cmim dukshëm me te ulët se cmimi juaj ofertues.

Pergjigjia e AK ne refuzimin e ankeses ne piken 2 eshte ne kundershtim me nenin 40 RRUPP 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Se pari OE konkurrues duhet te jete i pergjegjeshem ne aspektin administrativ, teknik, profesional atehere ne konsiderim qmimi i ofertes me i lire. Nese OE eshte i pa pergjegjshem nuk mund te shperblehet me kontrate pse eshte qmimi i ofertes me i lire pasiqe eshte ne kundershtim me piken 30.1 FID te doses se tenderit de neni 60 LPP-se

Dokumentat e ankesen gjindet ne e-prokurim tek OE konkurrues.

Ndërtimi- renovimi i objekteve me vlera historike kulturore ne Qytetin e Prizrenit

OE fitues U-UNIQUE - i pa pergjegjshem

PIKA ANKIMORE NR 1

Kërkes 1 Projektet e natyres se kontrates realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku perfshihen titujt e projekteve, numri,data e kontraktimit te standardeve dhe vlerat e tyre, vlera minimale e të githa projekteve te natyres se kontratës duhet te jete jo më e vogël se 75.000,00 €

Sipas kerkeses 1 FTD dosjes se tenderit nr 1 eshte kerkuar projektet e natyres se kontrates

Duke u bazar ne titullin e projektit ku kategoria e objekteve jane me vlera historike kulturore dhe objekti i cili

eshte parashikuar te Rivilohet sipas projektit te perpiluar nga Qendra trashigimise Kultrore ne Prizen eshte Objekti i shoqatave te Burgosurve ne Prizren i cili si Objekt eshte objekt i trashigimise kulturore dhe sipas Ligjin e trashgimise kulturore se objektet e trashgimise kultuore jane nen mbrojte.

Sipas Listes se kontratave, Kontratave - referencave apo pranimeve teknike OE fitues UNIQUE nuk ka ofruar deshmi se ka realizuara kontrata-projekte sipas natyres se projektit Ndertim-renovim te objekteve me vlera historike-kultutore and eshte I pa pergjegjshem.

PIKA ANKIMORE NR 2

Kërkesa 2 - a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri i projektit i cili duhet të jetë inxhinier i diplomuar i ndërtimtarise drejtimi konstruktiv ose master me jo me pak se 5 vite përvojë pune no profesion - Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës.

Deshmija 2 -

a. Duhet te caktohet me vendim menaxheri i proicktit,
CV-ia,
diploma e menaxherit,
dëshmi mbi përvojën në punë,
deshmi mbi menaxhimin e projekteve,
kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për ketë projekt me OE në fjalë. –
b, c. Diplomat , dëshmi mbi kualifikimin e stafit profesional te kërkuar, dëshmi mbi pervojen në pune, kontrata e punës ose kontrata e bashkepunimit

Projekt menaxher eshte caktuar Florim Istrefi.

-Projekt menaxheri z. Istrefi **nuk ka deshmi se ka menaxhuar se paku nie projekt te natyres se kontrates** , Bazuar se natyra e objektit eshte ndertimi, renovimi I objekteve me vlera historike kulturore, dmth z, Istrefi nuk ka qene argumentuar se ka menaxhuar nje projekt te trashigimise kulturore sipas natyres se projektit

Githeashtu

Deshmite te dorezuar per se paku 5 vite pervoje punes ne profesion
Ne dosje tenderit per z Istrefi jane dorezuar Cv dhe referencat
Sipas Cv dhe references se leshuar nga OE AL trade sqarohet se ka qene I angazhuar nga data 07/07/2004 deri me daten 31/01/2009.

Z. Istrefi ka diplomuar me daten 23/04/2008 qe dmth pervoja e punes nga data 07/07/2004 deri tek diplomimi 23/04/2008 eshte I pa pranueshem pasiqe nuk ka pas te fituar titullin - ska qene I diplomuar.

Ndersa sipas CV sqarohet se z, Istrefi ka qene I angazhuar ne kompanin Astraplan nga 28/12/2007 dhe vazhdon , ndersa sipas references te leshuar me daten 30/12/2016 nga OE Astraplan sqarohet se ka qene I angazhuar nga

01/01/2009 dhe vijon, ndersa sipas kontrates se nenshkruar ndermjet z, Istrefi dhe OE Astraplan se dates 04/01/2018 sipas nenit 4 te kontrates citoj: i punesuari themelon marredhenje pune na data 04/01/2018 deri me daten 31/12/2022 dhe sipas nenit 5 te kushteve kontrates i punesuari eshte I detyruar te filloje punen me daten 04/01/2018.

Se pari ka mosperputhje ndermiet referenca, CV-se dhe kontrates rreth angazhimit te z. Istrefi tek kompania Astraplan, Duhet konsideruar dokument te pa vlefshem

PIKA ANKIMORE NR 3

Kërkesa 3 Të ketë së paku 10 të punësuar me profile te ndryshme adekuat per realizim te kontrates.
Dëshmi 3 Lista e të punësuarve bashkë me përshkrimin e shkurtër te vendit te punës.
Per stafin e rregullt , kontratat e punes te skanuar nga origjinali ose kopjet kontratave.

OE fitues U-UNIQUE ka dorezuar ne dosje Listen e punetoreve ku sipas Listes ka shenuar emrat sipas numrit ne piken 1,2 dhe 3 ka te cilen jane te angazhuar me marreveshje bashkepunimi ndersa ne piken 4,5,6 jane staf profesional, ndersa nga pika 7 deri ne piken 15 jane 10 të punësuar me profile të ndryshme adekuat per realizim te kontratës. Ku jane bashkengjitur edhe kontratat.

NE LISTEN E STAFIT DHE PUNETOREVE profesional per realizim kontrates DHE SIPAS KONTRATAVE JANE VETEM 9 PERSONA TE CILET JANE PER REALIZIMIN E KONTRATES. Andaj nuk eshte plotesuar kerkesa prej 10 punesuareve profesional

2. BG- ING- AGE GROUP - TE PA PERGJEGJSHEM

PIKA ANKIMORE NR 1

1. Marreveshja e konserciumit ndermjet OE BG-ing dhe Age group **eshte e pa plote plotesuar** pasiqe nuk eshte ne pajtueshmeri me paragrafin 27.1 te nenit 27 RRUPP.
OE BG-ing dhe Age group kan dorezuar vetem marreveshjen e konserciumit sipas pikes a te paragrafit 27.1 te nenit 27 RRUPP por **nuk kan dorezuar secili deklarate te veqant secili** anetare sipas pikes b te pagrafit 27.1 te nenit 27 RRUPP.
27. Grup i Operatorve Ekonomik 27.1 Nje tender mund te dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik. Ne këte rast grupi, me tenderin e tyre, duhet te:
a. Dorëzon nje deklarate të qartë që të gjithë anëtarët e grupit jane se bashku dhe individualisht pergjegjës për përmbajtjen e tenderit te grupit, performancën e kontratës:
b. Dorëzon nje deklaratë te nenshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon piesëmarrien e tyre ne grup dhe se nuk jane duke marre piese individualisht dhe/ose ne grupe tiera ne procedurën e njëitë te prokurimit (deklarata elektronike mund te nenshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik te avancuar);

PIKA ANKIMORE NR 2

Kërkesa 2 - a. Në kuader te stafit duhet te caktohet menaxheri i projektit i cili duhet të jete inxhinier i diplomuar i

ndertimtarisë dreitimi konstruktiv ose master me jo me pak se 5 vite pervoje pune ne profesion - **Te ketë menaxhuar së paku nje projekte te natyres se kontrates.**

BG-ing ka caktuar menaxher **Astrit Gashi** i cili eshte Ingjinier I ndertimtarise
Nuk eshte dorezuar ndonje Reference e deshmon se ka menaxhuar ndonje projekt te natyres se ndertim-renovim te objekteve me vlera historike kulturore, pasiqe duke u bazuar se objekti eshte I natyres se trashigimise kultore.

Referenca e dorezuar ne dosie tenderit e leshuar na Euroing nuk ka te pershkruar se ka menaxhuar si menaxher ndonje objekt te natyres se projektit ku objekti eshte projekt I natyres se trashigimise.

Referenca e dorezuar ne dosje tenderit e leshuar nga OE BG-ing e dates 23/05/2022.
Ne reference pershkruhet se z. Gashi qene I angazhuar ne kompanin BG-ing gjate periudhes 01/02/2016 gjere me tani, sipas dates se leshimit te references 23/05/2022 dhe ne Listen e ATK-se se vitit 2022 e OE BG-ing e konstaton se se angazhimi I z. Gashi tek OE BG-ing eshte me informata te rrejshme pasiqe sipas Listes ATK-se se vitit 2022 z, Gashi nuk ngjindet, dhe sipas ligjeve per cdo pune te angazhuar duhet paguar Tatim.

Pika ankimore nr 3

Sipas CV se Ingjinieri te Arkitektures z.Vezir Morina , pershkruhet se ka punuar ne kompanin BG-Ing nga viti 2018 dhe Vazhdon ndersa nuk ngjindet ne listen e punëtoreve ne ATK-se.

Pika Ankimore nr 1 ndai Hysen Sopa BI.

Ndërtimi- renovimi i obiekteve me vlera historike kulturore ne Oytetin e Prizrenit.

Duke u bazar ne titullin e projektit ku kategoria e objekteve jane me vlera historike kulturore dhe objekti i cili eshte parashikuar te Rivilohet sipas projektit te perpiluar nga Qendra trashigimise Kultrore ne Prizen eshte Objekti i shoqatave te Burgosurve ne Prizren i cili si Obiekt eshte objekt i trashigimise kulturore dhe sipas Ligjin e trashgimise kulturore se objektet e trashgimise kultutore jane nen mbroite.

Sipas Listes se kontratave, Kontratave - referencave apo pranimeve teknike OE Hysen Sopa nuk ka ofruar deshmi se ka realizuara kontrata-projekte sipas natyres se projektit Ndertim-renovim te objekteve me vlera historike-kultutore anda eshte I pa pergjegishem.

Pika Ankimore nr 2 ndai OE Hysen Sopa BI

Kërkesa 2 - a. Në kuader te stafit duhet te caktohet menaxheri i projektit i cili duhet te jete inxhinjer i diplomuar i ndertimtarisë drejtimi konstruktiv ose master me jo me pak se 5 vite pervojë pune në profesion - Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës.

Déshmija 2 -

b. Duhet te caktohet me vendim menaxheri i projektit,

CV-ia,
Diploma e menaxherit,
dëshmi mbi pervojën në punë,
deshmi mbi menaxhimin e projekteve,
kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për këtë projekt me OE në fjalë. –
b, c. Diplomat, dëshmi mbi kualifikimin e stafit profesional të kërkuar, deshmi mbi përvojën në punë, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit.

OE Hysen Sopa Bi sipas dosjes se tenderit ka caktuar menaxher te projektit Afrim Demiri
I cili ka me z. Demir parakontrate per projektin
Z. Demiri **nuk ka deshmi -reference se ka menaxhuar se** paku nje projekt **te natyres se projektit ,** Natyra e Projekti **Objekti i shoqatave te Burgosurve ne Prizen** eshte objekt I trashigimi historike- kulturore dhe eshte si objekt I trashigimise kulturore dhe eshte I mbrojtur si objekt I trashgimise me ligj.

Pika Ankimore nr 3 ndaj OE Hysen Sopa BI

Kërkesa 4 Të ketë në pronësi edhe këto pajisje teknike

a .se paku një kamion te tonazhit nga 5 deri 10 ton (pesha bartëse).
b. Një kamion vetshkarkues me kran te peshes deri 10 ton (pesha bartese)

Deshmia 4 a, - te kent libreza te registrimit te cilat duhet te kene validitet, Dëshmi mbi marrien në shfrytëzim te ketyre pajisjeve duhet të deshmohet me kontratë. b, duhet te deshmohet me DUD. ose kontrate shitblerje. d. duhet te dëshmohet me deklaratë dhe me fotografi se posedon. Dëshmi mbi marrjën në shfrytëzim të ketyre pajisjeve duhet të dëshmonet me kontratë

Per kamion me numer tabelave 01-947 -QL. nuk eshte dorzuar foto siq eshte kerkuar ne deshmin e kerkeses nr 4

Marreveshia bashkepunimi ndermjet AAB Construction shpk dhe NNSH EMSA eshte e dates 08/10/2020 per listen e paisjeve te vitit 2022. Eshte marreveshje e pa vlefshme sepse eshte e pa mundur qe behet marreveshje perpara 2 vite per paisjet e vitit 2022.

Ne marreveshje bashkepunimi nuk jane cekur emertimi I paisjeve pasiqe kerkesa ka qene deshmi mbi marrjen ne shfrytezim te ketyre paisjeve **duhet me deshmu me kontrate.**

Andaj OE Hysen Sopa BI eshte i pa pergjegishem pasiqe nuk ka plotesuar kerkesen dhe deshmin ne piken 4.

Pika Ankimore nr 4 ndaj OE Hysen Sopa BI

Kërkesa 3 Të ketë së paku 10 të punësuar me profile te ndryshme adekuat për realizim të kontratës.

Dëshmi 3 Lista e te punësuarve bashkë me përshkrimin e shkurter të vendit të punës.
Për stafin e rregullt, kontratat e punës të skanuar nga originali ose kopjet kontratave.

OE Hysen Sopo **ka ofruar vetem 4 punetore te profileve te ndryshme adekuate per realizimin te kontrates, ku sipas kontratave te dorezuar ne dosje tenderit** sic jane:

1. Martir Demiri-Menaxher ndertimi, 2. Muhamet Sopa economist-specialist druri, 3. Jeton Buqa - Mjeshter | suvatimit de 4. Bashkim Veselaj-Murator.

Ndersa 1.Fatbardha Sopi, 2. Leonora Demiri, 3. Albesa Gashi sipas kontratave te dorezuar ne dosje jane **ADMINISTRATORORE.**

Ndersa 1.Lumturie Ahmeti-Arkitekte, 2.Naim Demiri-Inginier I Hidros, 3.Bekim Demiri - Ingjiier I elektros dhe 4. Petrit Demiraj -Ekonomist/kontabilist.

Permes kontratata OE Hysen Sop per ta plotesuar kerkesen nr 3 te dosjes se tenderit **ka dorezuar vetem 4 te punesuar me profile te ndryshme adekuate per realizimin e kontrates**. Nuk e ka plotesuar kerkeses se paku 10 te punesuar me profile te ndryshme adekuate per realizim te kontrates ku si des

SHKELJET LIGJORE:

Prova paragrafi 1 neni 1 LPP: Qëllimi i ketij ligji është te siguroj mënyrën mé efikase, me transparente dhe me te drejtë te shfrytezimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te githa fondeve dhe burimeve të tiera le autoriteteve kontraktuese ne Kosove duke percaktuar kushtet dhe rregullat de do E batohen, procedurat që do tendiqen, te drejat që do te respekto Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Prova paragrafi 1 neni 6 Lpp -se : Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Prova paragrafi 1, 2 dhe 6 neni 7 Lpp-se

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne menyre te barabarte dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në menyre transparente.

Neni 59, I LPP-së, ju si AK MKRS nuk keni vleresuar, egzaminuar he Krahasuar proceduren tenderuese te vleresimit ne pajtim me LPP pasiqe keni shperblyer me kontrate OE fitues i cili nuk i ka plotesuar kriteret e

percaktuar ne dosjen e tenderit

Neni 60, i LPP-së, ju si AK duke mos respektuar nenin 60 te LPP-se ku percaktohet ne piken 1.1 te neni 60 se duhet te shperblehet OE konkurrues i cili i cili eshte i pergjegishem me qmim me te lire, e ne kete rast ju si AK keni shperbly me kontrate OE fitues i cili nuk i ka plotesuar kriteret e percaktuar ne FTD,

Neni 69 LPP-se, OE fitues U-Uunique, BG-ing @ Age group, Hysen Sopa BI jane te pa pergjegishem pasiqe nuk i kan plotesuar kerkesat e stafit profsional dhe teknik rreth stafit te kerkuar dhe paisjeve te nevojshme te kerkuar sipas kritereve ne FTD dosje tenderit.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të merrni:

Të nderuar/a kerkoime nga ju që te zbatoni procedurat dhe dispozitat e LPP-se, sepse jeni te thirrur ta beni ketë gjë dhe mos vazhdoni te na diskriminoni dhe te na dëmtoni, për shkak se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontratë dhe natyrisht duhet te jemi fitues të kësaj kontrate dhe për të ardhur deri këtu kemi berë një punë, angazhim dhe mund të madh, dhe kemi berë shpenzime materiale.

Duke u bazar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që te merrni:

Të nderuar/a kërkojmë nga ju si OSHP, që te detyroni autoritetin kontraktues që të zbatojë procedurat dhe dispozitat e LPP-së, sepse janë të thirrur ta bejnë këtë gjë, dhe ta detyroni që mos vazhdojnë te na diskriminojnë dhe te na dëmtojne neve sepse ketë e ndalon neni 7 i LPP-se, andaj nga ju (OSHP) kërkojmë që ti ushtroni kompetencat ligjore, që të detyroni autoritetin kontraktues që të respektojë procedurat e prokurimit konform dispozitave të LPP-së.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të merrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa per rishqyrtim e OE "Albi Company"

ANULOHET, njoftimi per vendimi i AK-se te aktivitetit të prokurimit dhe lenda te kthehet ne rivleresim , dhe te shperblehemi si OE pasiqe jemi te pergjegishem me qmim me te lire.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional: **Kërkes 1 Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien**

koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri,data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 75.000,00 € Kërkesa 2 - a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri i projektit i cili duhet të jetë inxhinjer i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion - Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës. -b. Një inxhinier i diplomuar ose master i arqitekturës me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. -c. Një inxhinjer i diplomuar ose master i elektros me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion.	elektronike, të deshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të punëve. Dëshmija 2 - a. Duhet te caktohet me vendim menaxheri i projektit,CV-ia, diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për ketë projekt me OE në fjalë. -b, c. Diplomat , dëshmi mbi kualifikimin e stafit profesional të kërkuar, dëshmi mbi përvojën në punë, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për këtë projekt.
Kërkesa 3 Të ketë së paku 10 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës. Kërkesa 4 Të ketë në pronësi edhe këto pajisje teknike -a .së paku një kamion të tonazhit nga 5 deri 10 ton (pesha bartëse) . - b. Një kamion vetshkarkues me kran të peshës deri 10 ton (pesha bartëse)	Dëshmi 3 Lista e të punësuarve bashkë me përshkrimin e shkurtër te vendit te punës. Për stafin e rregullt , kontratat e punës të skanuar nga origjinali ose kopjet të noterizuar të kontratave . Për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit të skanuar nga origjinali ose kopjet të noterizuar të kontratave për këtë projekt. Dëshmia 4 a, - të kenë libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, Dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve duhet te dëshmohet me kontratë.b, duet te dëshmohet me DUD. ose kontratë shitblerje. d. duhet te dëshmohet me deklaratë dhe me fotografi se e posedon. Dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve duhet te dëshmohet me kontratë.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	Ndërtimi- renovimi i objekteve me vlera historike kulturore ne Qytetin e Prizrenit		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	" U - UNIQUE " SH.P.K., 810147513	10000	Rr.Holger Petersen

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

OE i pergjegjshem me d5mim ma te ulet.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Albi Company shpk"- Rahovec

Përgjigje në Pretendimet:

I. PIKA ANKIMORE NR 1

Kërkes 1 Projektet e natyres se kontrates realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku perfshihen titujt e projekteve, numri,data e kontraktimit te

standardeve dhe vlerat e tyre, vlera minimale e të githa projekteve te natyres se kontratës duhet te jete jo më e vogël se 75.000,00 €
Autoriteti Kontraktues ka vendosur kërkesa të cilat i ka mbështet edhe në vlerësim. Projektet e natyres se kontratës nëse shohim kërkesat e vendosura te përshkrimi i cmimit shohim se OE UNIQUE me listen e prezantuar për projektet e realizuar dhe dëshmitë për to i mbulon këto kërkesa, si dhe nisur nga fjalori i prokurimit i vendosur nga AK (FPP) shohim së është për punë ndërtimore, gjë që mbulohet nga ky OE. Andaj, **konsiderojmë se pretendimi ankimore është i pabazuar**. Kërkesat e AK-së janë të ngjajshme me punët apo kërkesat edhe për ndërtimet tjera, specifikë për këtë projekt është vetëm kujdesi i shtuar në mos-dëmtime eventuale.

PIKA ANKIMORE NR 2

Lidhur me pretendimet ankimore për menaxherin e OE-së se rekomanduar për kontratë z. Florim Istrefi.
Për menaxherin në fjalë nga dokumentet e marrura nga AK, kemi te prezantuar Diplomën, CV-në dhe disa letra reference. Diploma e vërteton se është inxhineri i drejtimit të kërkuar, CV e dëshmon se ka me tepër se 5 vite përvoje pune, si dhe referencat.
Kërkesa nuk ka qene 5 vite pas diplomimit por vetëm 5 vite pervoje pune megjithatë, z. Istrefi në bazë te dokumenteve të dorëzuar ka mbi 5 vite përvojë pune edhe pas diplomimit.
Referenca e z.Istrefi nga kompania ASTRAPLAN shpk është për pozitën menxher ekzekutiv dhe tregon për angazhimin e z.Istrefi (përshkrimi në referencë përshtatet më kërkesat e AK-së, menaxhim i projekteve në të gjitha fazat e projektit, përfshirë fushën e inxhinerisë se ndërtimit dhe restaurimit), kjo reference është leshuar ne vitin 2016 (referenca dëshmon vitet 2009-2016).
Ndërsa, kontrata është për pozitën e drejtorit dhe është nënshkruar me 04.01.2018 deri me 31.12.2022. (Ku deri me tani i bjen ti ketë pothuajse 4 vite pervojë pune). Nga këto dy deshmi shohim se z. Istrefi ka mbi 5 vite pervoje pune. **(Pretendim i pabazuar)**

PIKA ANKIMORE NR 3

Nga dokumentet e ofruara nga AK, kemi një listë prej 15 personave, ku 14 prej tyre kanë profesion që nderlidhet me projektin, si dhe nje kontabilist. Si dhe janë të bashkangjitura 12 kontrata- kontrata e Florim Istrefit është tek vendimi për menaxher si marreveshje e bashkëpunimit, mungon vetëm kontrata e personit të dytë Hamdije Idrizi Krasniqi në listë e dorëzuar. Gjithashtu, AK ka kërkuar kontrata vetëm për stafin e rregullt. As ky pretendim **nuk është i bazuar.**

II. BG- ING- AGE GROUP - TE PA PERGJEGJSHEM

PIKA ANKIMORE NR 1

"Marreveshja e konserciumit ndermjet OE BG-ing dhe Age group eshte e pa plote plotesuar pasiqe nuk eshte ne pajtueshmeri me paragrafin 27.1 te nenit 27 RRUPP.
OE BG-ing dhe Age group kan dorezuar vetem marreveshjen e konserciumit sipas pikes a te paragrafit 27.1 te nenit 27 RRUPP por nuk kan dorezuar secili deklarate te veqant secili anetare sipas pikes b te pagrafit 27.1 te nenit 27 RRUPP".
Marrëveshja e dorëzuar nga ky grup i OE-ve, brenda vetës i përfshin të gjitha pikat sic janë të përcaktuara në RrUOPP dhe është e nënshkruar nga dy palët . **Andaj, ky prentendim nuk mund te merrët i bazuar.**

PIKA ANKIMORE NR 2

Pretendim pjesërisht i bazuar z.Gashi ka referenca që thotë se ka udhehequr punimet, si dhe ka pervojë pune mbi 5 vite, që është **prentendim i pabazur**. Por, **e bazuar** është qe nuk gjinden në listën e punetorëve për vitin 2022.

PIKA ANKIMORE NR 3

Pretendim I bazuar z. Vezir Morina nuk gjinden në listën e punëtorëve për vitin 2022.

III. PIKA ANKIMORE NR 1 NDAI HYSEN SOPA BI.

Pretendimi 1- i pabazuar dëshmi të mjaftueshme janë ofruar lidhur me projektet të ngjajshme.

Pika Ankimore nr 2 ndaj OE Hysen Sopa BI

Ky pretendim ankimor është plotësisht **i pa bazuar** dëshmi të mjaftueshme, lidhur me menaxherin z.Demiri OE ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për menaxhim të projekteve.

Pika Ankimore nr 3 ndaj OE Hysen Sopa BI

Pretendim i bazuar – mungon fotografia, marrëveshja është e vitit 2020.

Pika Ankimore nr 4 ndaj OE Hysen Sopa BI

OE ka ofruar një listë prej 44 personave të punësuar, një listë të ATK-së prej 15 personave të punësuar, si dhe ka ofruar kontratat për stafin e rregulltë.

Duke u bazuar në përgjigjet e sipër listuara shohim se shumica e pretendimeve ankimore janë të pabazuara, edhe ato të bazuarat nuk e ndryshojnë vendimin e AK-së, rekomandoj që kjo ankesë të konsiderohet si i pabazuar. Përgjigjet janë bazuar në dokumentet e ofruar nga AK lidhur me pretendimet ankimore.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura dhe rëndësin e tyre:

- Ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar;
- Të mbetët në fuqi njoftimi mbi vendimin e AK-së;
- AK të vazhdoj më procedurë konfrom legjislacionit në fuqi.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Komunës se Prizrenit;
- Panelit Shqyrtues - OSHP;
- OE ankues - Albi Company shpk- Rahovec.